



**MESAZHI I MYFTIUT
ME RASTIN
E KURBAN BAJRAMIT
1436/2015**



**FIRMËTARË
NË EMËR TË ALL-LLAHUT**



**SELAM
PASTË IBRAHIMI (A.S.)...**

Viti XIII - Nr. 9 (151),
Shtator, 2015

Botim i Myftinisë Shkodër

UDHA ISLAME

*E përmuajshme
Informative - Fetare
Kulturore - Edukative*

KURBAN BAJRAMI, DITË VËLLAZËRIMI DHE HARMONIE ISLAME





Imam Muhamed Sytari
Myfti i Zonës Shkodër

Të gjitha falënderimet e plota dhe madhështia absolute i takojnë vetëm All-llahut të Madhëruar, Zotit të Vetëm të gjithësisë, i cili e lartësoi pozitën e të diturve deri në atë gradë, sa i konsideroi të pamësuarit, si të verbër, kur tha: “A është i njëjtë ai që e di se ajo që t’u shpall ty nga Zoti yt është e vërtetë, si ai që është i verbër? Vetëm njerëzit e arsyeshëm që kanë mendje të shëndoshë e kuptojnë të vërtetën.”¹

Salavatet dhe përshëndetjet më të përzemërta ia dërgojmë sot në këtë ditë të begatë të këtij muaji të begatë, në këtë periudhë të begatë të 10 ditëve të para të muajit Dhul-Hixhe, (për të cilat është betuar edhe Zoti në Kur’an), zotërisë së bijve të Ademit, Hz. Muhammedit (a.s), i cili thoshte për veten e tij: “Jam dërguar Mësues!”²

TË NDERUAR MEDRESISTË, VËLLEZËR DHE MOTRA BESIMTARË,

Këtë të hënë, edhe për medresistet dhe medresistët tanë, nisi një vit i ri shkollor, që zyrtarisht sinjalizon një rrugëtim të ri dhe një mundësi të re drejt thellimit të mëtejshëm në dije, moral e besim.

Ndonëse jemi në periudhën e begatë të 10 ditëve të para të muajit Dhul-Hixhe, që mbyllen me Festën e bukur të Kurban Bajramit, ku natyrisht, në minberet e ndryshme të vendit e të botës, sot flitet për vlerën dhe rëndësinë e shtimit të adhurimeve në këtë periudhë, me agjërim, dhikër, sadeka, rregullim të marrëdhënieve farefisnore, kurbane në ditën e bajramit

1. Kur’ani, Err-Rra’d: 19.

2. Pjesë e një hadithi të gjatë, transmetuar nga Ibn Maxheh dhe daremiu, nga Abdull-llah ibn Amr ibnul-As (r.a).

“GJËJA MË E MIRË ME TË CILËN KALOHET KOHA DHE ANGAZH OHET NEFSI”

etj, zgjedha që mesazhin e kësaj jave t’ia drejtoj fëmijëve tanë, prindërve, mësuesve dhe njëkohësisht vetes time, në raport me fillimin e këtij viti të ri shkollor.

Po lexoja mbi vlerën e dijes dhe më tërhoqi vëmendjen një artikull i vitit 1923, nga një autor me emrin H. Xhafer, në revistën “Zani i Naltë”. Ka dy konstatime të kundërta në mes vete, por thellësisht nxitëse për të reflektuar në raportet që ne dhe fëmijët tanë kemi me dijen dhe kërkimin e saj.

Shkruan: “Më të diçmit Myslimantë si i mbaronin Medreset (Universitetat) prapë nuk pushonin, por për me u ba specialistë vazhdonin, e kesi soj gjer sa vdisnin shkonin prej një specialist ne tjetëri aqë sa bëheshin ma të mëdhenj e të dijshmëve.

Për faqe të zezë të sotshmit, sa mbarojnë një shkollë; librat i flakin dhe për pak kohë harrojnë edhe ato qi kanë kenduem”³

TË DASHURIT E MI,

Sot, kur mbarë bota islame është ndezur nga sprovat e shumta dhe të panumërta, që po vënë në lëvizje mendjet e dijetarëve drejt gjetjes së zgjidhjeve më të urta, për tejkalimin e këtij pragu, këshilla më e mirë dhe shërbimi më i mirë, që mund t’i bëjmë fëmijëve dhe rinisë tonë është udhëzimi drejt dijes dhe thellimi në të.

Sepse dituria, është rrugë drejt moralit, civilizimit, kulturës, përparimit, rregullimit dhe ndërtimit në tokë, përhapjes së më të mirës (nëse është e shoqëruar me frikën e Zotit), mundësimi të rikthimit tonë në pozitë e krenarisë dhe lavdisë së hershme. Tamam, siç e thotë edhe përkthyesi i shquar i Kur’anit në gjuhën angleze, Marmaduke William Pickthall (1875-1936): “Muslimanët mund ta përhapin civilizimin e tyre me të njëjtën shpejtësi që e përhapën edhe më parë, nëse do të kthehen tek morali që posedonin

3. H. Xhafer, “Vlehtë e ditunis”, revista “Zani i Naltë”, nr. 4, Tiranë, kallnuer 1923, vit’ i I, f. 122. (Nga kolana “Zani i Naltë”, vëllimi i parë: 1923-1924-1925, botimet KMSH, Tiranë, 2014). (Me përshtatje të lehtë. M.S.)

*“Më të diçmit
Myslimantë si
i mbaronin Medreset
(Universitetat) prapë
nuk pushonin, por për
me u ba specialistë
vazhdonin,
e kesi soj gjer sa
vdisnin shkonin prej një
specialist ne tjetëri
aqë sa bëheshin
ma të mëdhenj
e të dijshmëve.
Për faqe të zezë
të sotshmit, sa
mbarojnë një shkollë;
librat i flakin dhe
për pak kohë
harrojnë edhe ato
qi kanë kenduem”*

herën e parë. Sepse kjo botë boshe nuk mund të qëndrojë përpara civilizimit të tyre”⁴

Prandaj, këshilloj veten, fillimisht, ju të dashur nxënës medresistë, mësuesit dhe drejtuesit e nderuar të Medresesë së Shkodrës (krejt medreseve), që ta shfrytëzojmë maksimalisht kohën në shërbim të këtyre qëllimeve të larta.

Mos të na shkojë koha pa dobi dhe

4. El-Husejni El-Husejni Muaddi, “Ulema ve hukema minel-garbi ensaful-Islam”, botimi i parë, Damask, 2007, f. 63.

të punojmë me sa të kemi mundësi për të ndërtuar një brez me besimtarë të hapur ndaj botës, jo të mbyllur në guacka provinciale a mentalitete njerëzish që akoma nuk janë çliruar nga komplekset individuale, nga mendësitë shtrënguese, nga angazhimi me gjëra të vogla dhe pa dobi, që natyrshëm e frenojnë zhvillimin normal të fëmijëve dhe rinisë tonë, në mos e kthejnë edhe kundër asaj drejt së cilës përpiqemi të thërrasim, duke i hyrë në hak!?

Të kemi kujdes, në atë që veprojmë dhe shfaqim, sepse përgjegjësia e jonë është e dyfishtë, sidomos kur e jashtëmja e jonë të fton drejt fetares, e veprat tona drejt hipokrizisë, Zot na ruaj!?

Medreseja e jonë është amanet i shtrenjtë i brezave dhe i vetë shpirtit të Thirrjes Islame dhe Qytetërimit Islam në këtë vend. Duhet të qëndrojmë plot krenari dhe dinjitet, jo të bjerë në nivele provinciale e mesquine, që nuk kalojnë as klasën e parë në qytetari, kulturë, dije e largpamësi!

Dijetari i shquar, Shejkh Abdulfettah Ebu Guddeh thoshte se: “Një derhem pasuri ka nevojë për një kuintal mendje. Një derhem dije ka nevojë për dy kuintal mendje”⁵

TË DASHUR TË PRANISHËM,

Kam lexuar se në urtësitë e tij drejtuar mësuesve dhe nxënësve të dijes, dijetari i shquar i shekujve të shkuar, Ibn Xhemaa, në librin e tij të dobishëm, me titull: “Përkujtim për folësin dhe dëgjuesin mbi moralin e dijetarit dhe kërkuesit të dijes”, teksa flet për moralin e nxënësit, thotë: “E treta: Ta shfrytëzojmë rininë dhe kohën e tij për të zënë dituri dhe të mos vetëkënaqet me mashtrimet e shprehjes: “do ta bëj” a shpresës në zënie më vonë, sepse çdo orë që kalon nga jeta e tij, nuk zëvendësohet më, as nuk kthehet...”⁶

Prandaj, të dashur e të shtrenjtë medresistë, pash hatrin e Zotit, mos e vrisni kohën tuaj me gjëra të padobishme, por shfrytëzoheni kohën tuaj, në shërbim të diturisë, sepse, sikurse na kanë mësuar dijetarët tanë: “Libri s’ta fal sekretin e tij, po s’e lexove të tërin”⁷

Për shkak të angazhimit të tyre me dijen dhe shfrytëzimin maksimal të kohës, dijetarët e shquar muslimanë, korifejtë e diturisë ndër shekuj, arritën të ishin ata që ishin dhe të jenë pishtarë udhëzimi akoma edhe sot, për krejt ne.

Po lexoja se “Imami, Shejkhul-Islami Ibn Tejmije, që lindi në vitin 661 h. dhe ndërroi jetë në vitin 728 h., 67 vjeç, la pas rreth pesëqind vëllime në vepra”⁸, ndërsa “El-Hafidh Ibn Xherir Et-Taberi, Hoxha i mufesirëve, muhadithëve dhe historianëve, vetëm biografia e tij arrinte në 56 faqe të mëdha. Ai lindi në vitin 224 h., ndërroi jetë në vitin 310 h., 86 vjeç.

Dhe po të hiqen 14 vitet e para pjekurisë nga jeta e tij dhe të pjestohen vitet e tjera me trashëgiminë e tij të botuar, do të dalë se për çdo ditë të jetës së tij, ka shkruar nga 14 fletë, ndryshe 358 (treqind e pesëdhjetë e tetë) mijë fletë!

Vetëm “Historia” e tij është shtypur në 11 vëllime të mëdha, ndërsa “Tefsiri” i tij është shtypur në 30 vëllime të mëdha. Ai konsiderohet si një kompleks shkencor, si një shtëpi botuese, përse i përket shumësisë së botimeve të tij”⁹

Ja, dijetari i shquar Imam Ibn Akil, i cili “ka lindur në vitin 431 h., ndërroi jetë në vitin 513 h., (pra, 82 vjeç), konsiderohet si një ndër inteligjentët e racës njerëzore. Thoshte: “Nuk më lejohet të humbas as një orë nga jeta ime! Edhe nëse më lidhet gjuha për të folur a debatuar, vë në punë mendjen time, edhe në gjendje pushimi, ashtu i shtrirë, sa që kur ngrihem kam çfarë të shkruaj!..”

Ai shkroi një libër të madh, të quajtur: “El-Funun” (Artet), në 800 vëllime, sa që Imam Dhehebiu thoshte: “Nuk është shkruar në këtë botë, libër më i madh sesa ky libër!” Libër në të cilin ka mbledhur e shkruar rreth diturive të ndryshme, si në: tefsir, fikh, usul, gjuhë arabe, poezi, histori etj.”¹⁰

Në parathënien e librit të tij, “El-Funun”, Ibn Akili shkruan: “Gjëja më e mirë me të cilën kalohet koha dhe angazhohet nefs, si dhe afrohet me

*SEPSE DITURIA,
ËSHTË RRUGË
DREJT MORALIT,
CIVILIZIMIT,
KULTURËS,
PËRPARIMIT,
RREGULLIMIT DHE
NDËRTIMIT NË TOKË,
PËRHAPJES SË
MË TË MIRËS (NËSE
ËSHTË E SHOQËRUAR
ME FRIKËN E ZOTIT),
MUNDËSIMIT
TË RIKTHIMIT TONË
NË POZITAT
E KRENARISË DHE
LAVDISË SË HERSHME.*

të te Zoti i Madhëruar, është DITURIA, që të nxjerr nga errësira e injorancës drejt dritës së fesë...”¹¹

Dhe shembujt e dijetarëve tanë janë kaq të shumtë, sa nuk do të dilte krejt kjo ditë për t’i renditur e prezantuar, në rrugën e përfitimit nga shembulli i tyre.

Po e përfundoj me thënien e mendimtarit Arthur Hamilton (1926 jeton në ShBA), që shkruan se: “Sikur njerëzit ta parashikonin të vërtetën, do ta



Dr. Muhamed V. Sulejman

Kur Ibnul-Kajjim e titulloi librin e tij "Kolosë firmëtarë në emër të All-llahut" e bëri atë fjalë të përjetshme për çdokënd që mbart flamurin e kësaj feje dhe thërret drejt saj. A e kupton çdokush që mbart këtë mesazh, madhështinë e përgjegjësisë?

A arrijnë ta kuptojnë se malli i tyre është qëllimi i krijesave për të fituar dhe shpëtuar? Për këtë ata thërrasin me të vërtetën (hakun), të qartë në thirrjen e tyre, duke ua sqaruar njerëzve fenë, deri edhe në çështje madhore, të cilat kërkojnë guxim në të vërtetën.

Kjo qartësi e tyre dhe mungesa e lëshimeve është sekreti i qëndrueshmërisë në thirrje, kështu që, kushdo që dëshiron të vërtetën e pason atë, dhe atij që All-llahu nuk e do udhëzimin e tij, edhe njerëzimi mbarë, nuk e zotërojnë diçka të tillë.

Firmëtarët në emër të All-llahut, nuk ofrojnë lëshime në fe, sepse qëllimi i tyre është dërgimi i njerëzve dhe thirrjes së tyre tek All-llahu, sado që të këmbëngulin armiqtë, duke ofruar kesi lloj lëshimesh, edhe sikur me heshtje ndaj shkeljeve të tyre,

FIRMËTARË NË EMËR TË ALL-LLAHUT

"Ata dëshirojnë të bësh lëshime (të mashtrosh), që edhe ata pastaj të bëjnë lëshime (mashtrojnë)".

Firmëtarët për All-llahun, dispozitat e tyre i mbështesin me argumente të sheriatit dhe nuk gjykojnë me diçka tjetër, përveç sheriatit të tyre, në çdo çështje, e vogël apo e madhe qoftë: "Thuaj: Nuk ju them se, tek unë janë depot e All-llahut, e as nuk e di të fshehtë (gajbin) dhe as ju them se, unë jam melek. Unë nuk pasoj, vetëm se çfarë më shpallet mua".

Firmëtarët për All-llahun, ata janë të parët, që zbatojnë atë për çfarë bëjnë thirrje dhe, veprat e tyre nuk i kundërshtojnë fjalët që thonë. "Thuaj: O popull im, çfarë mund të thoni, nëse unë jam në rrugë të qartë prej Zotit tim dhe më ka furnizuar me rrësk të mirë prej Tij, e as nuk dua t'ju kundërshtoj në atë që ju ndaloj prej saj. Unë nuk kam për qëllim, veçse rregullimin, aq sa kam mundësi, dhe mbarësia ime nuk është, veçse me All-llahun. Tek Ai mbështetem dhe tek Ai pendohem e kthehem".

Firmëtarët për All-llahun nuk kanë ambicie dynjaje. Në llogaritë e tyre nuk ka këtu përfitime, e as atje rezidenca, apo përfitime prestigji, ose pasurie. Synimi i tyre është adhurimi i krijesave Krijuesin, "Thuaj: Nuk u kërkoj ndonjë shpërblim për të. Kjo është, vetëm se përkujtim për botët".

1. Kur'ani, El-Kalem: 9.
2. Kur'ani, El-En'am: 50.
3. Kur'ani, Hud: 88.
4. Kur'ani, El-En'am: 90.

Firmëtarët për All-llahun, janë plotësisht të bindur për Zotin e tyre, kur atyre u fryjnë stuhitë, e i godasin fatkeqësitë. Natyrisht, edhe ata janë njerëz, e i godet çfarë i godet gjithë njerëzit, por ata besojnë se, përfundimi është për të devotshmit. Kështu që, besimi dhe bindja e tyre për All-llahun, asnjëherë nuk lëkunden, qoftë as edhe sa grimca më e vogël, "A menduat se do të hyni në xhenet, e të mos ju vijë shembulli i atyre që ishin përpara jush? Ata i goditi fatkeqësia dhe vështirësia, e u lëkunden, derisa tha i dërguari dhe ata që besuan me të: Kur është ndihma e All-llahut? A nuk është ndihma e All-llahut afër!"

Ata janë fenerët e udhëzimit dhe treguesit e dritës. E mësuan, e kuptuan dhe e njohën të vërtetën (hakun). Rendin me sakrifica për pastrimin e Islamit nga çdo mashtrim, turbullim, apo ndërhyrje. Janë të vendosur për të drejtën, mesataristë në thirrjen e tyre dhe refuzues të çdolloj ekstremizmi, ose neglizhimi, por kiameti më i madh është atëherë, kur atyre u shkon për shtat fjala e All-llahut: "Dhe, kur u thuhet atyre: Mos bëni shkatërrime në tokë, ata thonë: Ne jemi rregullues!"

Përktheu nga arabishtja:

Lavdrim Hamja

5. Kur'ani, El-Bekare: 214.
6. Kur'ani, El-Bekare: 11.

*Ata janë fenerët e udhëzimit dhe treguesit e dritës.
E mësuan, e kuptuan dhe e njohën të vërtetën (hakun).
Rendin me sakrifica për pastrimin e Islamit
nga çdo mashtrim, turbullim, apo ndërhyrje.
Janë të vendosur për të drejtën, mesataristë në thirrjen e tyre
dhe refuzues të çdolloj ekstremizmi, ose neglizhimi.*

“PRISJA TË SHIHJA PRANË ÇDO XHAMIE, NJË FABRIKË DHE, PRANË ÇDO MINAREJE, NJË OXHAK!”

*Ngado islamofobi! Islamofobi e përkthyer në lëvizje politike.
Islamofobi e përkthyer në kulture. Islamofobi e përkthyer në investime publike.
Islamofobi e përkthyer në hapësira televizive e mediatike!?*

Tashmë, që numrin një në klasifikimin e temave për debat në rrjetet sociale (dhe përtej tyre), e ka zënë “birra pa alkool” dhe larmia e ecejakeve, plot tekste e argumente, pyetje-përgjigje e kundërpërgjigje, u ndala për pak dhe, teksa po ndiqja kurbën e këtij “debati”, si një shirit dëshmues, para syve më kaluan 25 vitet e fundit, të mbushura me debate e tematika, si kjo e fundit, që kanë zënë kohën e një pjese të mirë të njerëzve, plot “tha” e “thotë”.

M’u kujtuan debatet pa lidhje të ditëve të para, të pas vitit '90 rreth disa temave krejtësisht të padobishme dhe nxitëse të përgjumjes intelektuale, si: ajo e pozicionimit të duarve në namaz, rreth tubimit a jo për “mevlud”, për mbledhjen a jo për Hatmen e plotë të Kur’anit në Ramazan, për numrin e rekateve të teravisë, për abdestin pa larjen e këmbëve (thjeshtë prekjen me dorë të çorapeve), për thirrjen “amin” me zë të lartë pas imamit, (pas këndimeve me zë), për mosbërjen e dhikreve me xhemat, për... e sa shumë për-e...

Ndërkohë, nga viti 1990, (nga fillimi i nëntorit të atij viti) e në vazhdim, deri sot, (kur po paguajmë haraçet e përgjumjes së elitave tona islame, teksa dëgjojmë mllafe dhe urrejtje kundër Islamit dhe muslimanëve nga megaphone, që shpërndajnë vner falas, ditë pas dite), temat e lartpërmendura vazhdojnë të kërkojnë të imponohen si frymëzime elitare, në mesin e muslimanëve..?!

Pastaj u ndala për pak dhe ktheva kokën nga e kaluara; e largëta e afërt (ajo e 25 viteve) dhe e afërta e afërt (e ditëve dhe muajve të fundit). Ngado islamofobi! Islamofobi e përkthyer në lëvizje politike. Islamofobi e përkthyer në kulture. Islamofobi e përkthyer në investime publike. Islamofobi e përkthyer në hapësira televizive e mediatike!?

Pastaj m’u kujtua rrëfimi i kryemyftiut të Sirisë, Shejkh Ahmed Keftaro (1915-2004), i cili tregon për një bisedë me presidentin e Pakistanit, Ejub Han, gjatë një vizite në Pakistan, (në mbështetje të qëndrimeve të këtij vendi, në lidhje me çështjen e Kashmirit). Thotë: Presidenti më pyeti: Si të duket Islami në Pakistan?

Ia ktheva: Islami në Pakistan, më duket i dobët!

Tha: Si?

Ia ktheva: Kur e vizitova Pakistanin më parë, gjeta shumë xhami të bukura dhe minare tërheqëse. Tash, pas dhjetë viteve, në këtë vizitë të dytë, prisja të shihja pranë çdo xhamie, një fabrikë dhe, pranë çdo minareje, një oxhak! Po ta gjeja këtë, pas dhjetë viteve nga vizita ime e parë, do thoja se Islami në Pakistan, është ashtu si duhet të jetë! ...

Në fakt, realitetet e ndërlikuara shqiptare, ku janë përzier shumë duar (të papastra, më shumë të papastra, a më pak të papastra), kanë më shumë nevojë se kurrë për investimin tonë në dobi të lartësimit të komunikimit tonë fetar dhe social, si pjesë integrale e këtij vendi.

Është më e pakta, që i detyrohem Shqipërisë tonë, xhamive të saj, nivelit të komunikimit në mes vete, përpjekjes për të qenë faktor esencial në realitete të vjedhura e të marra peng, kudo përreth nesh!

Pa e ndryshuar mënyrën e të menduarit dhe të sjelljes në mes nesh dhe përtej komunitetit tonë, do të vazhdojmë të dëgjojmë korba e gjarpërinj të zinj, që nuk reshtin së përmbushuri misionin e tyre shekullor kundër Islamit dhe muslimanëve, në të gjitha mënyrat dhe format e mundshme, legjitime dhe ilegjitime, morale dhe imorale.

Imam Muhamed B. Sytari



“Prapambetja është krim që meriton të ndëshkohet. Popujt që mbajnë akoma shkaqet e prapambetjes, patjetër do t’i mbulojë, ato çfarë i ka mbuluar popujt gjatë historisë, veçanërisht myslimanët neglizhues ndaj Mesazhit të tyre!

Përparimi teknologjik është i domosdoshëm për mbështetjen e parimeve dhe plotësimi qytetërimor është esenca e shoqërive të shëndosha.

Ata, të cilët e konsiderojnë fenë çështje personale, apo rrugë individuale janë persona të sëmurë.

Dhe, ata të cilët nuk ia imponojnë veten mjedisit të tyre në të cilin jetojnë, ndërkohë që zotërojnë drejtimin e punëve dhe vënien e tyre në shërbim të besimeve, ata janë shoqëri të lehta që nuk kanë peshë në jetë”.

Shejkh Muhamed El-Gazali

(nga libri: El-Gazvu eth-thekafij jemteddu fi feragina)

MESAZHI I MYFTIUT TË SHKODRËS ME RASTIN E KURBAN BAJRAMIT 1436/2015

Të dashur besimtarë, vëllezër dhe motra muslimanë
Të nderuar bashkëqytetarë shkodranë

Lebbejkall-llahumme lebbejke, lebbejke la sherike leke lebbejke, innelhamde ven-ni'mete leke vel-mulk, la sherike leke, lebbejke!

Tashmë që mbarë bota islame është përqendruar me zemër e shpirt në vendin më të pastër e fushën më të begatë të adhurimit dhe lutjeve, Arefatin Sherifë, aty ku miliona haxhilerë nga mbarë globi, me rrobat e tyre të bardha, janë tubuar në lutje dhe adhurim drejtuar Zotit të Vetëm të botëve, All-llahut të Madhëruar, më lejoni t'ju drejtohem me këtë mesazh urimi.

Në mbarë botën sot, padrejtësia, anarshia morale, korrupsioni, haramet dhe veset më të ulëta njerëzore, po bëhen përherë e më shumë një thirrje për zgjimin e vëmendjes së besimtarëve për të dëshmuar fenë e tyre, Islamin e pastër, Dritën e tij, forcën e bashkimit dhe bashkëpunimit në mes vete, tamam si ata miliona njerëz me zemra të bardha dhe ihrame përkushtimi, të cilët po thërrasin me zemër, edhe në emrin e secilit prej nesh: "Lebbejkall-llahumme lebbejke", duke dëshmuar dorëzimin dhe përgjigjen ndaj thirrjeve të Hakut.

Sot, më shumë se kurrë, po na vërtetohet sesa e rëndësishme është ta dëshmojmë fenë tonë dhe të kapemi fort pas saj; të tjerët nuk e kanë humbur shansin e tyre!

Sot, ne si muslimanë e kemi për detyrë të shenjtë të rikthejmë vëmendjen tek mësimet dhe simbolet e fesë tonë, për ta dëshmuar moralin e fesë, me dinjitetin e dëshmimit të Islamit në jetë.

Të shumta janë sot thirrjet që ju tërheqin drejt largimit nga krenaria dhe dinjiteti islam, drejt thirrjeve të tjera në emër të kombit, harmonisë, shoqërisë etj, por që kanë për qëllim dobësimin e bindjes dhe besimit tonë; t'i bëjmë lanet e t'i gjuajmë me moralin e besimit tonë, tamam si haxhilerët që gjuajnë me guralecët e bindjes, simbolikën e shejtanit të mallkuar!

Të jeni të bindur, se me forcën e besimit tonë, do të jemi pa asnjë dyshim praktikues më të mirë të fesë,

shqiptarë më të mirë, mbrojtës të denjë të interesit kombëtar, që nuk mund të jetë assesit tjetërsimi fetar a zhveshja nga përkatësia jonë e shenjtë islame!

Dita-ditës po shohim sesi bota islame është ndezur në luftëra e dhunë, vrasje e zhvatje të pasurive kombëtare, laborator human për zhvillimin e viruseve më të egra të terrorizmit, ekstremizmit të urreyer fetar, intolerancës, mosrespektimit të vlerave fetare të kujtdo dhe lirisë së shprehjes, besimit dhe përkatësisë, tamam si

U trillua historia e jonë, u abuzua me simbolet tona, u shkatërruan xhamitë e teuhidit, u persekutuan hoxhallarët tanë, u ndalua rreptësisht praktika fetare dhe dëshmimi i shpirtit islam në një shoqëri thuajse islame, për të mbërritur në këto ditë, ku intrigat, padrejtësitë, shkeljet flagrante, mungesa e ekuilibrave, laicizmi selektiv dhe abuzimi me të drejtat legjitime të muslimanëve, po kthehen në një zakon ndaj të cilit duhet edhe të heshtim!?

katahura komuniste (një prodhim i kobshëm joislam), krimi i pashoq, terrorizmi shtetëror dhe padrejtësia shekullore ndaj muslimanëve shqiptarë, që për 23 vite u persekutuan dhe u dhunuan për shkak të fesë.

U trillua historia e jonë, u abuzua me simbolet tona, u shkatërruan xhamitë e teuhidit, u persekutuan hoxhallarët tanë, u ndalua rreptësisht praktika

fetare dhe dëshmimi i shpirtit islam në një shoqëri thuajse islame, për të mbërritur në këto ditë, ku intrigat, padrejtësitë, shkeljet flagrante, mungesa e ekuilibrave, laicizmi selektiv dhe abuzimi me të drejtat legjitime të muslimanëve, po kthehen në një zakon ndaj të cilit duhet edhe të heshtim!?

Kurban Bajrami vjen pikërisht për të zgjuar ndjenjat e besimit dhe për ta forcuar krenarinë e përkatësisë islame në zemrat e pjesës dominuese të këtij kombi, që Islamit e përqafoi si alternativë largpamëse, dritë për të sotmen, siguri dhe garanci për të ardhmen; në dije, moral, pastërti, harmoni komunitare, tolerancë ndaj jomuslimanëve, respekt dhe vlerësim ndaj krejt qenieve, si krijesa të Një Zoti!

Më lejoni t'ju uroj me zemër këtë Kurban Bajram, që përkon edhe me 25 vjetorin e rihapjes së xhamisë së parë në Shqipëri, pas viteve të errësirës, si një datë dhe ditë e shtrenjtë, që na fton përherë e më shumë drejt vlerësimit të mirësisë së Zotit ndaj nesh, xhamitë e shumta të Shkodrës e mbarë Shqipërisë, nga minaret e të cilave ezani ju fton pesë herë në ditë për të mos shitur fenë, për të mos thyer besën, për të mos devijuar rrugën!

Përhapeni gëzimin tuaj legjitim, festën e madhe të Kurban Bajramit!

Mos kini ndrojtje për ta dëshmuar Islamit tuaj dhe mos u tundoni nga trendi i shëmtuar i kohëve që kalojmë, që ju bën të



Idmir Plaku,
imam, xhamia "Ebu Bekr"

Cdo vit, me rastin e festës së Kurban Bajramit vjen në kujtesën tonë Ibrahim (a.s) me familjen e tij. Allahu (xh.sh) e përjetësoi kujtimin e tyre duke i dhënë një vend të veçantë në historinë njerëzore, si shembull frymëzimi për besimtarët.

Ibrahim (a.s) është i dërguari dhe i dashuri i Allahut, i respektuari dhe i dashuri i krejt besimtarëve. Muhamedi (a.s) e ka lartësuar, nderuar dhe respektuar, sa herë që është kujtuar Ibrahim (a.s). Transmetohet nga Enesi (r.a) që thotë: "Erdhi një person tek Pejgamberi (a.s) e i tha: O krijesa më e dobishme! Pejgamberi a.s iu përgjigj: "Ai është Ibrahim (a.s)"¹ Ndërsa kur Pejgamberi (a.s) u ka thënë sahabeve: "Vertetë që do të tuboheni këmbë zbatuar dhe të zhveshur", pastaj lexoi ajetin kuranor: "Ashtu sikundër e kemi filluar krijimin (tuaj), do ta rikthejmë. Ky është obligimi Ynë, e Ne e bëjmë këtë"². Në lidhje me këtë ajet kuranor Pejgamberi (a.s) ka thënë: "Ibrahim është i pari që do të vishet në ditën e Gjykimit".³

Allahu (xh.sh) e bëri prijës të njerëzimit sepse përmbushi të gjitha obligimet. Në lidhje me këtë Allahu (xh.sh) thotë: "Përkujto kur Zoti i vet, Ibrahimin e provoi me disa obligime, e ai i përmbushi ato, e Ai i tha: "Unë po të bëj ty prijës (imam) të njerëzimit!"⁴. Kjo pozitë që iu dha Ibrahimit (a.s) ishte e merituar, Allahu (xh.sh) dëshmoi për të duke thënë: "Dhe të Ibrahimit, që gjithnjë i plotësoi obligimet"⁵. Duke qenë shëmbëlltë e të mirave, Allahu (xh.sh) e urdhëroi Muhamedin (a.s) të ndiqte fenë e tij. Për këtë thotë: "Pastaj, ty të shpallëm: Ndiqe fenë e drejtë të Ibrahimit, se ai nuk ka qenë nga idhujtarët (as jehudi as i krishterë)"⁶.

SELAM PASTË IBRAHIMI (A.S)...

Ishte ky, i dashur i Allahut që e emërtoi ymetin e Muhamedit (a.s) me emrin mysliman. Allahu xh.sh thotë: "Dhe nuk ju obligoi në fë me ndonjë vështirësi, në fenë e Ibrahimit. Ai edhe më parë, e edhe ky (Kur'an) ju quajti mysliman."⁷

Siç vërehet, ruajtja e besimit të pastër monoteist të Ibrahimit (a.s) iu la amanet Muhamedit (a.s) dhe ymetit të tij. Për të kryer ato obligime, të cilat edhe vetë Ibrahim (a.s) i ka bërë. Transmetohet se Pejgamberi (a.s) ka porositur shokët e tij që kur të zgjohen nga gjumi të thonë: "Jemi zgjuar në natyrën e pastër islame, në fjalën e sinqeritetit⁸, në besimin e te dërguarit tonë Muhamedit (a.s) në fenë e Ibrahimit (a.s) besimtarit të drejtë që nuk ka qenë nga idhujtarët."⁹

Ka qenë Ibrahim (a.s), i cili e ndërtoi Qaben e madhnueshme, thirri ndër njerëz për ta vizituar dhe bërë haxhin. Vizita e Qabes është dëshmi e gjallë e begatisë së thirrjes së Ibrahimit (a.s), pozitës së tij tek Allahu (xh.sh). Prandaj Pejgamberi (a.s) dhe ymeti i tij u urdhëruan të ndjekin si vendfalje, vendin ku qëndroi Ibrahim (a.s). Në këtë kontekst, Allahu (xh.sh) thotë: "Dhe kur shtëpinë (Qaben) e bëmë vendkthimi dhe vendsigurie për njerëzit (u thamë) Vendin ku qëndroi Ibrahim, pranojeni për vendfalje!"¹⁰

Pranimi si vendfaljeje i vendit të Ibrahimit (a.s) nga besimtarët në ditët e sotme është vërtetësi e ndjekjes së tij dhe ringjalljes së gjurmëve të tij. Ka qenë Ibrahim (a.s) shëmbëlltë e të mirave dhe, i përngjasuari më i madh me të ka qenë Muhamedi (a.s). Në këtë kontekst transmetohet se Pejgamberi (a.s) ka thënë: "E kam parë Ibrahimin (a.s) dhe më i përngjasuari ndër njerëz me të është shoku juaj", duke nënkuptuar veten e tij."¹¹ Siç ngjasonte Pejgamberi (a.s) me Ibrahimin (a.s) në aspektin fizik, ashtu ishte edhe në atë praktik. Transmetohet se Pejgamberi (a.s) i ka kërkuar mbrojtje Allahut (xh.sh) për Hasanin dhe Hysenin, me të njëjtat fjalë siç ka kërkuar Ibrahim (a.s) për Ismailin (a.s) dhe Ishakun (a.s), duke thënë: "Kërkoj mbrojtje me fjalët e përsosura të Allahut nga dëmi i çdo shejtani dhe nga dëmi i syrit të keq"¹²

Me të drejtë është thënë për Ibrahimin (a.s), zemra e tij ka qenë e Allahut, djali i tij ka qenë për kurban, trupi i tij për zjarr

dhe pasuria për miq. Mikpritjen e tij, Allahu (xh.sh) e përjetësoi duke thënë: "A ke arritur të dëgjosh ti për rrëfimin e mysafirëve të ndershëm të Ibrahimit? Kur patën hyrë tek Ai dhe thanë: "Të përshëndesim me paqë!" Ai tha: "Qofshi gjithnjë të përshëndetur me paqë!" (E me vete tha): "Njerëz të panjohur!" Dhe ai pa i vërejtur, shkoi te familja e vet dhe solli një viç të majmë të pjekur. Atë ua afroi atyre e tha: "Përse nuk po hani?"¹³

Ky është Ibrahim (a.s) i dashuri i Allahut që për besimtarët hapi derën e dialogut me idhujtarë e ateistë duke u bazuar në dituri e argument, bëri që e vërteta të triumfojë mbi gënjeshtrenë. Në lidhje me këtë Allahu (xh.sh) thotë: "Këto janë argumentet Tona që ia dhamë Ibrahimit kundër popullit të tij. Ne e lartësojmë në shkallë të lartë atë që duam"¹⁴.



Sheikh Vehbi S. Gavoçi

DISA HADITHE PËR HZ. ALIUN (R.A)

1. Profeti (a.s) i thotë hz. Aliut: “Ti je për mua si hz. Haruni me hz. Musanë (a.s), mirëpo nuk ka profet mbas meje.”¹

2. Hyri hz. Aliu te Profeti (a.s), i cili iu çue në këmbë. Hz. Abbasi (r.a) i tha: Hej i dërguari i Zotit (xh.sh), a e do ti Aliun?

Profeti iu përgjigj: “O xhaxhai im, e dua dhe Zoti e do më shumë se e dua unë.”

3. Në një hadith tjetër Profeti (a.s) thotë: “Ty të do besimtari e të urren hipokriti (dyfytirëshi).”²

4. Hz. Aliu ka thënë: Ju e dini prestigjin tim te Profeti (a.s) si i afërti i tij, si djali i xhaxhait më ka mbajtur në prehër, kur isha i vogël. Kur u rrita, nuk ka dëgjuar prej meje gënjeshtër as ka parë gabim në sjellje, isha përherë pranë tij, si fëmija pranë nënës së vet, për ditë shihja e studioja sjelljet e veçanta të tij dhe gjithnjë më urdhëronte t’i pasoja ato.”

EMRI I TIJ

Aliu, djali i Ebu Talibit, djali i Abdul Muttalibit, djali i xhaxhait i Profetit (a.s). Nëna e tij quhej Fatime, vajza e Esedit. Ka lindur mbas Profetit (a.s) në vitin 601. Ka qenë i pari djalë që pëlqeu fenë Islame. Ka qenë më i vogli djalë i familjes, nga katër që kishte: Akili, Xhaferi, Fadhi (Um-mu Harri) dhe Aliu. Si llagap quhej Ebu Hasan, për djalin e tij Hasanin.

NË SHTËPI TË MUHAMMEDIT (A.S)

Një vit për Meken e për vende të

1. Bukhari.

2. Muslimi.

KALIFI I KATËRT HZ. ALIU (R.A) (DJALI I EBU TALIBIT)

tjera që i vështirë, nuk ra shi, njerëzit vuajtën shumë.

Profeti (a.s) i tha xhaxhait të vet, Abbasit, se xhaxhai Ebu Talibi ishte në gjendje të keqe për jetesë, pse kishte shumë fëmijë. Në bisedë e sipër ai i propozoi që të shkonin tek ai e të përpiqeshin për t’ia lehtësuar pak gjendjen. Abbasi pranoi. Shkuan tek ai dhe i kërkuan për t’i marrë ndonjë fëmijë për ta ndihmuar për kapërcimin e vështirësive të jetesës.

Ebu Talibi u tha: Merrni kë të doni, veç më lini Akilin këtu. Abbasi mori Xhaferin. Profeti (a.s) mori hz. Aliun, i cili qëndroi tek ai, derisa u rrit e u bë burrë.

Ibn Is’haku, historian me famë, kallëzon: Kur vinte koha e të falurit, Profeti (a.s) dilte nga shtëpia për një anë të malit në Mekë. Me të shkonte për t’u falur edhe Aliu, fshehurazi nga babai i vet. Vazhduan kështu për një kohë, faleshin, më vonë ktheheshin në shtëpi.

Një ditë, Ebu Talibi e pau Profetin (a.s) që po falej e i tha: Çka beson, o nipi im?

Profeti (a.s) iu përgjigj: Kjo është feja e Zotit (xh.sh), u ka pëlqyer melekëve, profetëve dhe mua më ka dërguar Zoti (xh.sh) profet për njerëzit.

Ti, o xhaxha, je më i afti për këshillimin tim dhe për të më ndihmuar.

Ebu Talibi i tha: O nipi im, unë nuk mundem të lë fenë e babës e të gjyshërve, mirëpo sa të jem gjallë do të të ruaj nga çdo e keqe që mund të të ndodhë ty.

Mandej iu drejtua djalit të vet, Aliut: Çfarë feje ke? Aliu iu përgjigj: Kam besim në Profetin (a.s).

Ebu Talibi, mbasi dëgjoi të birin, u shpreh: Muhamedi nuk thërret, veç për të mirë, pra pasojë, bëhu me të! Sepse hz. Aliu jetonte në shtëpi të Profetit (a.s) ishte përherë me të, në shërbim të tij, sepse djemtë që i lindën Profetit (a.s) i vdiqën të vegjël.

Kur u urdhërua Profeti (a.s) për të

emigruar mbas 13 vjetësh, urdhëroi hz. Aliun për të fjetur në shtratin e tij, që të kujtonin idhujtarët se ai Zotëri flë në shtratin e vet.

Profeti (a.s) i tha hz. Aliut: “Flij në shtratin tim e mos u frikëso, se nuk të gjen gjë. Të nesërmen kthejua pasuritë atyre që ua kam ruajtur, mandej eja për në Medinë”.

Ashtu veproi. Hz. Aliu u zgjua në mëngjes mbas një gjumi të qetë e të ëmbël, nuk pësoi asnjë fjalë të ligë nga armiqtë, u dorëzoi njerëzve pasuritë e tyre. Në vazhdim mori rrugën për në Medinë, vetëm e në këmbë, ecte natën e u fshihte ditën, mos t’i dilte para ndokush.

MARTESA E HZ. ALIUT

Mbas luftës së Uhudit, në vitin e 3-të të emigrimit, kur hz. Aliu ishte 21 vjeç, mendoi të martohej. E dinte se Profeti (a.s) ka veç një vajzë të pamartuar, ka Fatimen 16-vjeçare. Dëshiroi ta kërkonte. Po si, kush të ndërmjetësonte? Vëllezërit ishin në Mekë, xhaxhai Hamza ra dëshmor në luftën e Uhudit.

Mori kurajo e shkoi vetë te Profeti (a.s), përshëndeti, qëndroi sa qëndroi, por turpi nuk e lejoi të flasë çka dëshironte.

Vetë Profeti (a.s) i tha: Pse ke ardhur?

- A don të fejosh Fatimen, i tha hz. Aliu me zemër të hapur.

- Po, tha Profeti (a.s), po ç'do të paraqitësh si kurorë?

- S'kam gjë, u përgjigj hz. Aliu.

Profeti (a.s) vazhdoi: Ke devetë që fitove në luftën e Uhudit dhe armën.

- Po, ata janë pra kurorë.

Profeti e urdhëroi të përgatisë banesën për njeriun e ri.

U kënaqën të gjithë muslimanët për atë martesë.

Para martesës Aliu i tha Profetit (a.s): Martesa do gosti. Saidi tha se e kishte një dash e do ta sillte. U çuan të tjerë ansarë, dikush dha grurin, dikush diçka tjetër dhe në këtë mënyrë u përgatit materiali për gatimin e gostës së martesës.

U thirrën njerëzit, hëngrën e gëzuan dhe u shpërndanë të kënaqur për atë rast aq të bukur.

Profeti i madh (a.s) përcolli vajzën e vet aq të dashur me një copë kadife si mbulojë, me një ibrik uji për të pirë e për ta përdorur për abdes, një shtrat për të fjetur të mbushur me li e nënkresë të mbushur me barë të thatë (sanë) e një shtroje modeste për tokën që ishte shtruar me rërë.

Kjo qe dhuntia e paja e Fatimes që Profeti (a.s) e donte më tepër se asnjë tjetër.

Hej djem të rinj, hej vajza të reja, martohuni, edhe pse nuk keni sot veç shumë pak rroba, se Zoti (xh.sh) ua shpërblen e ua shton ushqimin që ka premtuar në Kur'an. E rëndësishme është të jetë familja me anëtarë të mirë, që duan ta mbrojnë veten

nga rrëshqitja e të ketë familje me harmoni, me fëmijë e në pëlqimin e Zotit (xh.sh)

Zonja Fatime u bë zonjë shtëpie. Hz. Aliu ishte i vobektë, punonte pak, ishte i dhënë pas kërkesave të Profetit (a.s) për luftë dhe për çdo gjë kur e kërkonte, prandaj hoqi keq kjo vajzë aq e fisnike.

Pa asnjë ankesë ajo bartte ujin prej së largu për në shtëpi, bluante tërshërën ndërmjet dy gurëve, e shtynte dhe e sillte mullirin me dorë, saqë iu çuan mëshikëza e iu formuan kallo. Kur pastronte tokën e shtëpisë së vet, çohet pluhur që e dëmtoi në gjoks. Kur mori Aliu përgjegjësinë e sjelljes së ujit në shtëpi, iu duk zonjës Fatime punë e madhe.

Profeti (a.s) ndau punët ndërmjet vajzës së vet e dhëndërrit. Punët e jashtme të shtëpisë, për të përgatitur e sjellë çka kishte nevojë shtëpia, ishin punë të Aliut (të burrit), kurse punët brenda shtëpisë, për pastrimin, për rregullin brenda shtëpisë me kërkesat e saj ishin punët e Fatimes (gruas).

Kur erdhën robër të zënë në luftë, shkuan hz. Aliu me hz. Fatimen për të kërkuar një rob si shërbëtor, mirëpo nuk e gjetën Profetin (a.s) në shtëpi. Kur u kthyen në shtëpi e i kallëzuan se ka ardhur dhëndërrin me zonjën Fatime, ai Zotëri shkoi tek ata dhe i pyeti se çka kërkonin.

Hz. Fatimeja i tha: Babë, shikoji duart e mia, më janë bërë tërë mëshikëza e më është fryrë mishi i duarve, po më dhemb gjoksi nga puna e rëndë. Na jep një rob që të më lehtësojë punët e rënda që kam.

Profeti (a.s) me fjalë të ëmbla, por në mënyrë solemne i tha: Si t'u jap juve rob, kur kemi njerëz që nuk kanë bukë për të ngrënë? Jo, jo, ju do t'u mësoj një gjë që është më e mirë se kjo që kërkonin.

- Çka është ajo, -thanë burrë e grua përnjëherësh.

Përpara se të flini, natën thoni 33 herë Subhanellahi, 39 herë Elhamdulil-lahi, 34 herë Allahu ekber.

Ata të dy e pëlqyen atë dhuratë që vërtetë është më e mirë, se sjell shpërblim të madh. I vazhduan ato fjalë për natë, si i vazhdojmë dhe duhet t'i vazhdojmë edhe ne.

Hej djem të rinj, hej vajza të reja, martohuni, edhe pse nuk keni sot, veç shumë pak roba, se Zoti (xh.sh) ua shpërblen e ua shton ushqimin që ka premtuar në Kur'an.

Hz. Aliu ka marrë pjes

KURBAN DITË BESIMT



BAJRAMI, DËSHMIE...



H. BURHAN FILI MBAN HYTBEN E XHUMASË NË XHAMINË E PARRUCËS

Me ftesë të Myftiut të Shkodrës, Imam Muhamed Sytari, ditën e xhuma, më 28 gusht 2015, H. Burhan Fili, mbajti hytben e xhumasë në xhaminë e Parrucës.

Gjatë saj, thirrësi islam me banim dhe aktivitet në Michigan të ShBA, foli mbi rëndësinë e vlerësimit të mirësisë së udhëzimit në jetë dhe falënderimin ndaj Zotit të gjithësisë, prej të Cilit janë krejt mirësitë në jetë.

Ai bëri thirrje që njerëzit ta shfrytëzojnë kohën për të gjetur dritën e besimit, për të prekur udhëzimin dhe për t'u përkushtuar në jetë, me dëshirën e mirë të ndërtimit.

H. Burhan Fili iu referua ajeteve dhe haditheve, që nxisin shfrytëzimin e jetës në shërbim të vlerave të udhëzimit hyjnor dhe fytyrë të besimit.

Me shumë emocion, ai rrëfeu edhe momentet e vështira të arratisjes nga



vendlindja dhe ndihmën e Zotit ndaj tij, për t'u larguar në botën e lirë, ku edhe u arsimua dhe zgjodhi rrugën e thirrjes islame, me urtësi e largpamësi.

Pas namazit të xhumasë, H. Burhan

Fili u takua me besimtarë të shumtë, që e uruan për hytben e xhumasë dhe për kontributet e tij të vyera, sidomos pas vitit '90, në shërbim të rimëkëmbjes së Thirrjes Islame.

MYFTIU: "TË ZGJOHEMI PËR TË JETUAR ME DINJITET ISLAMIN TONË!"

Ditën e xhuma, më 4 shtator 2015, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, mbajti dersin e xhumasë në xhaminë e Parrucës, ku dha mesazhe të qarta mbi gjendjen e sotme në botën islame.

"Ditën e djeshme, Unioni Botëror i Dijetarëve të Muslimanëve, që e drejton Shejkhul-Islami i kësaj kohe, Shejkh Jusuf El-Karadavi, dha një udhëzim, ku foti të gjithë vaizët dhe

hatibët e botës të flasin mbi vuajtjet dhe persekutimin e muslimanëve në botë dhe ata të Sirisë në veçanti.

Prandaj, edhe ne në Shkodër e kemi për detyrë të bashkohemi me mbarë ymetin islam, si një zemër e vetme, në solidarizim me vuajtjet e mbarë botës islame, që persekutohet dhe dhunohet vetëm për shkak të fesë!

Islamofobia, me tentakulat e saj, po përpiqet me të gjitha mundësitë e saj

të errësojë dritën e Zotit, por këtë nuk e arrin dot, nuk do ta arrijë asnjëherë, kurrë nuk ia ka arritur!?

Prandaj ju ftoj sot të lutemi bashkarisht dhe të zgjohemi për të jetuar me dinjitet Islamin tonë, edhe këtu ku jemi, në vendin tonë, në tokën tonë, në tokën e gjyshërve tanë, që për pesë shekuj udhëhoqën dhe drejtuan botën, me drejtësi, dije, humanizëm dhe kulturë!

Ta refuzojmë persekutimin e fshehtë për shkak të fesë, që vazhdojmë ta ndjejmë në situata dhe realitete të ndryshme në vendin tonë", - tha Myftiu.

Gjatë dërsit të tij, Myftiu përmendi edhe faktin e elementëve persekutues ndaj muslimanëve shqiptarë, pas vitit 1990, në drejtime të ndryshme, si në arsim, administratë, në fondet publike, në drejtim të vajzave muslimane me hixhab e përtej tyre.

Në dersin e sotëm, Myftiu lajmëroi se hytbeja e sotme e xhumasë do të mbahet nga i nderuari, H. Ethem Haliti, nga Gostivari, një njeri i nderuar që ka shërbyer në Shkodër, sidomos në vitet e para të rimëkëmbjes islame, pas vitit 1990.



H. ETEM HALITI MBAN HYTBEN E XHUMASË NË XHAMINË E PARRUCËS

Ditën e xhuma, më 4 shtator 2015, me ftesë të Myftiut të Shkodrës, hytbeja e xhumasë në xhaminë e Parrucës, u mbajt nga Hafiz Etem Haliti, nga Gostivari.

Në fillim të hytbes së tij, Hoxha i nderuar shprehu emocionet e tij dhe mirënjohjen drejtuar Shkodrës dhe muslimanëve të saj, për mikpritjen dhe bashkëpunimin, sidomos në periudhën e pas vitit 1993, kur ai shërbeu si imam, vaiz dhe mësues feje në Shkodër.

Gjatë hytbes së xhumasë, H. Etem Haliti ftoi muslimanët që të bashkohen në qëllime të larta, duke mënjanuar elementët e ndarjes dhe mosmarrëveshjes, duke u dëshmuar si një shoqëri e lidhur dhe e fortë në vetvete.

Ai tha: “Mos të bëjmë sot veprime, për të cilat, brezat që do vijnë, do na qortojnë! Asnjëherë në historinë islame vllavrasja në mes muslimanëve është



quajtur xhihad! Kjo që po shohim sot, nuk ka arsytim islam, nuk ka lidhje me fenë tonë! Ndoshta, pas dy a tre shekujsh, brezat e ardhshëm do ta quajnë këtë që jetojmë sot, si: mesjeta islame, ndonëse muslimanët nuk kanë kaluar kurrë “mesjetë”, si popujt e

kulturat e tjera!”

Pas përfundimit të namazit të xhumasë, H. Etem Haliti këmbëu urime dhe lutje me xhematin e shumtë, që kishin ardhur ta takonin dhe ta uronin për mesazhet e dhëna në hytben e sotme.

TAKIME TË KËNDSHME ME NXËNËSIT E MËSIM-BESIMIT

Të hënën, më 7 shtator 2015, sektori i arsimit, pranë Myftinisë Shkodër organizoi një takim me nxënësit e mejtepit të xhamisë Oblikë, që mësojnë nën kujdesin e mësuesit të tyre të apasionuar, z. Ritvan Luzaku.

Në këtë takim mori pjesë drejtuesi i arsimit, teologu Arben Halluni, i cili gjatë takimit me ta, u mbajti një bisedë fetare, ku u foli për rëndësinë që ka zhvillimi i mësim-besimit për njohuritë kryesore të Islamit dhe për edukimin e brezave sipas frymës së vërtetë tradicionale islame.

Ai u ndal edhe në mësimet edukative që marrin gjatë mejtepit, duke u

treguar se sa të vlefshme janë për një njeri që kërkon të ecë sipas besimit të tij, i cili është një garanci për një jetë plot besim, devotshmëri dhe moral të shëndoshë.

Ndërsa ditën e xhuma, më 11 shtator 2015, në xhaminë e Gurit të Zi u zhvillua procesi i testimit, niveli i parë për nxënësit, të cilët mësojnë në kursin fetar. Më pas u zhvillua ceremonia e shpërndarjes së çertifikatave dhe dhuratave simbolike për 17 nxënës dhe nxënës të suksesshëm në këtë kurs fetar.

Teologu Arben Halluni, pas falënderimit ndaj Allahut (xh.sh)



OBLIKË

falënderoi nxënësit për përgatitjen dhe prezantimin e vazhdueshëm në mejtepin e mësim-besimit, prindërit e tyre dhe mësuesin e përkushtuar, z. Bujar Ymeri, i cili gjatë një periudhe 1-vjeçare u mësoi këtij brezit të ri obligimet dhe kulturën islame që duhet të ketë një musliman i mirë dhe shembullor në mesin e shoqërisë apo vendit ku bën pjesë.

Nxënësit më të dalluar u shpallën: Arsen Haxhia, Arsen Sulejmani, Denis Ymeri, Aranit Lahi, Erald Lahi, Endri Haxhia, Arben Abdia dhe Ledina Sulejmani.



GURI I ZI

MYFTIU VIZITOI QENDRËN KULTURORE TURKE “YUNUS EMRE”



Ditën e mërkurë, më 9 shtator 2015, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed Sytari, zhvilloi një takim pune në Qendrën Kulturore Turke “Yunus Emre”, në Shkodër, ku u prit nga drejtori, z. Ömer Osman Demirbaş.

Myftiu e falënderoi mikpritësin e tij për kontributet që Qendra Kulturore “Yunus Emre” jep në Shkodër, në kuadër të prezantimit të kulturës, artit dhe traditave turke, nëpërmjet aktiviteteve të ndryshme, kurseve, takimeve, konferencave etj.

Imam Muhamed B. Sytari dhe z. Ömer Osman Demirbaş diskutuan edhe në lidhje me bashkëpunimin dypalësh të Myftinisë Shkodër me Qendrën Kulturore Turke “Yunus Emre”, sidomos në prag të përkujtimit të 25 vjetorit të rihapjes së xhamisë së Plumbit dhe Mevludit Sherifë.

Gjatë këtij takimi, drejtori i Q.K.T. “Yunus Emre”, e falënderoi Myftiun e Shkodrës për vizitën, si dhe shprehu kënaqësinë e tij për të kontribuar në drejtim të bashkëpunimit me Myftininë e Shkodrës.

Ai tha se qëllimet e Q.K.T. “Yunus Emre”, janë të qarta, sidomos në drejtim të bashkëpunimeve të frytshme, që e forcojnë edhe më shumë lidhjen shekullore të dy popujve tanë dhe traditave të tyre të përbashkëta.

Ai konfirmoi edhe një herë se Q.K.T. “Yunus Emre” është e gatshme për të mirëpritur propozimet e Myftinisë Shkodër në drejtim të bashkëpunimit dypalësh.

NISI TRAJNIMI I 22 HAXHILERËVE SHKODRANË TË KËTIJ VITI

Ditën e enjte, më 10 shtator 2015, pas namazit të akshamit në xhaminë e Parrucës, Myftinia Shkodër nisi trajnimin treditor të 22 haxhilerëve shkodranë të këtij viti, që do të nisen pas pak ditësh për të kryer umren dhe haxhin e këtij viti.

Teologu Ruzhdi Plangaj, që sivjet do të jetë pjesë e grupit të haxhilerëve shkodranë, në seancën e parë të kësaj nate, foli mbi vlerën dhe rëndësinë që ka kryerja e haxhit, si një prej pesë shtyllave kryesore të fesë islame.

Imami i nderuar i xhamisë Kiras, përmendi ajete dhe hadithe të ndryshme, ku vlerësohet madhështia dhe rëndësia e haxhit dhe umres, të paktën një herë në jetë, për atë që ka mundësi ekonomike dhe fizike.

Më pas, nisi të shpjegojë shtyllat kryesore të adhurimit të haxhit, kushtet e tij, lutjet, gjërat e ndaluara, ato të pëlqyera, veshjen e ihramit, ndalesat e tij etj, duke i përsëritur



e bashkëbiseduar me të pranishmit.

Një fjalë përshëndetëse dhe urim për haxhin e sivjetshëm e dha edhe Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, i cili theksoi se këtë vit, grupi i haxhilerëve shkodranë do të ketë në përbërje imamë dhe teologë, që do të jenë në ndihmë të tyre, si dhe

do të jenë një garanci më shumë për një udhëtim të mrekullueshëm besimi dhe adhurimi të pastër, drejt Shtëpisë së All-llahut të Madhëruar.

Trajnimi i haxhilerëve do të vazhdojë edhe ditën e xhuma dhe të shtunë, pas namazit të akshamit, në xhaminë e Parrucës.

MYFTIU VIZITOI KRYETAREN E RE TË BASHKISË SHKODËR, ZNJ. VOLTANA ADEMI

Paraditen e së enjtes, më 10 shtator 2015, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, zhvilloi një vizitë urimi në zyren e Kryetares së re të Bashkisë Shkodër, znj. Voltana Ademi, për ta uruar me rastin e zgjedhjes së saj në drejtim të Bashkisë Shkodër.

Gjatë këtij takimi, znj. Ademi falënderoi Myftiun për vizitën, duke shprehur vlerësimet e saj për bashkëpunimet e deritanishme të Myftinisë Shkodër me Bashkinë e qytetit.

Kryetarja e re e Bashkisë Shkodër, tha se të gjithë duhet të jenë bashkëpunues për të mirën e Shkodrës dhe qytetarëve të saj. Ajo konfirmoi rolin elitar të Myftinisë Shkodër dhe komuniteteve fetare në drejtim të ruajtjes dhe forcimit të paqes sociale dhe harmonisë në mesin e besimeve dhe pasuesve të tyre.

Nga ana e tij, Imam Muhamed Sytari, pasi e uroi znj. Voltana Ademi për përzgjedhjen e saj në krye të Bashkisë Shkodër, theksoi se dyert e bashkëpunimit do të jenë të hapura



dhe Myftinia do të jetë e gatshme për të dhënë kontributin e duhur në çdo moment, në këtë drejtim.

Me rastin e kësaj vizite, Myftiu i dhuroi Kryetares së re të Bashkisë Shkodër, znj. Voltana Ademi, një kujtim nga xhamia e kalasë Rozafa, ku theksoi se ky objekt kulturi islam, dëshmon për shekujt e Islamit në vendin tonë dhe për frymën

e besimit që karakterizon Shkodrën.

Myftiu tha se të gjithë duhet të bëjmë më shumë në drejtim të forcimit të besimit në shoqëri.

Në këtë vizitë, Myftiu shoqërohej nga antarët e Këshillit të Myftinisë Shkodër, z. Lavdrim Hamja, H. Fejzi Zaganjori dhe z. Arben Halluni.

CEREMONIA E SHPËRNDARJES SË IHRAVEVE TË HAXHILERËVE SHKODRANË

Pasditën e së hënës, më 14 shtator 2015, Myftinia Shkodër, organizoi ceremoninë e përvitshme të shpërndarjes së ihrameve të haxhilerëve shkodranë të këtij viti.

Pas faljes së namazit të iqinidsë, me xhemat, në xhaminë e Parrucës, ceremonia nisi me mesazhet e dhëna nga teologu Arben Halluni, i cili theksoi se haxhi është një adhurim i mrekullueshëm, që bashkon muslimanët e mbarë botës në një takim të pashembullt adhurimi dhe reflektimi mbi jetën dhe realitetet e ymjetit islam.

Më pas, Myftiu i Malësisë së Madhe, H. Edmir Smajlaj, dha këshillat e tij për haxhilerët e këtij viti. Ai u ndal te stacionet e ndryshme, nëpër të cilat do të kalojnë haxhilerët, duke porositur shfrytëzimin maksimal të kohës dhe shtimin e dhikrit dhe duave, sidomos në Arefat.

Më pas, të pranishmit i përshëndeti imami i nderuar, H. Agim Hoxha, i cili këndoi një ilahi të bukur kushtuar haxhilerëve, duke dhuruar emocione të bukura.



Ceremonia vijoi me fjalën e Myftiut të Zonës të Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, i cili tha se aktiviteti i sotëm ka një mesazh të fortë, që vërteton se shkodranët dhe shqiptarët nuk ia kanë kthyer shpinën Islamit të tyre. Ai tha se nesër, në mesin e miliona haxhilerëve nga mbarë bota, do ta shohin të gjithë flamurin tonë kombëtar, teksa valëvitet në qiejt e vendeve më të shenjta të botës, duke dëshmuar Islamin e shqiptarëve.

Më pas, Myftiu bëri një lutje në gjuhën

shqipe, për mbarësinë dhe pranimin e haxhilerëve të këtij viti.

Ceremonia vazhdoi me leximin e emrave të 22 haxhilerëve shkodranë të këtij viti, dorëzimin e pasaportave me vizat përkatëse, ihramin dhe orenditë e tjera shoqëruese.

Të pranishmit, u përshëndetën me haxhilerët, të cilët, me mbarësinë e All-llahut, udhëtojnë ditën e nesërme drejt vendeve të shenjta për kryerjen e haxhit të sivjetshëm.

Ditën e hënë, më 14 shtator 2015, nisi viti i ri shkollor 2015-2016. Si në krejt shkollat e vendit, edhe në Medresenë “Haxhi Sheh Shamia”, u zhvillua ceremonia e fillimit të vitit të ri shkollor.

I pranishëm në përshëndetjen e nxënësve, prindërve të tyre si dhe stafit të mësuesve, ishte edhe Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari.

Në fjalën e tij përshëndetëse, në degën e djemve, Myftiu uroi drejtorin e Medresesë, z. Kujtim Dervishi, si dhe Kryetarin e Shoqatës “Istanbul”, z. Ridvan Seferaj, për fillimin e vitit të ri shkollor. Njëkohësisht iu drejtua nxënësve me një këshillë të dijetarit dhe admiralit të shquar, Esed Ibnul-Furat, i cili, kur po nisej drejt përhapjes së Islamit në Sicili (më 17 qershor 827), iu drejtua njerëzve përreth me këto fjalë: “O ju njerëz, pasha All-llahun, prej mirësive më të mëdha të Zotit, me të cilat kam arritur, ku kam arritur, është dituria. Prandaj, shtrydheni mendjen dhe lodhini trupat për të zënë dituri, që të fitoni këtë botë dhe të përtejmen!”

Më pas, Myftiu uroi edhe medresistet e degës së vajzave, në ceremoninë e tyre, ku uroi një vit të mbarë e plot suksese. Ndër të tjera, Myftiu tha: “Data 14 shtator 2015 është një datë historike,

MEDRESEJA “HAXHI SHEH SHAMIA”, VITI I RI SHKOLLOR ME SIHARIQE TË REJA



pasi, për herë të parë në historinë e saj, medreseja e jonë ka tashmë tre godina. Sot, nis rrugëtimin e saj edhe godina e re e ciklit fillor, si një sihariq i madh për Shkodrën. Me këtë rast, dua të shpreh falënderimet dhe mirënjohjen më të madhe për ata burra të nderuar, të cilët dhanë nga pasuria e tyre për këtë mirësi në Shkodër. Dhe meqë

jemi në djepin dhe shtëpinë e babait të abetareve shqipe, Daut Boriçit, më lejoni t’ju kujtoj disa vargje të shkruara me dorën e tij, që i kam gjetur gjatë hulumtimeve të mia. Thotë: “Mëso o bir (o bijë), sepse injoranca është turp...”.

Më pas, Myftiu zhvilloi një vizitë edhe te godina e re e medresesë, cikli fillor.

HAXHILERËT E SHKODRËS, DREJT VENDEVE TË SHENJTA



Ditën e martë, më 15 shtator 2015, Myftinia Shkodër organizoi ceremoninë e përshëndetjes dhe përcjelljes së haxhilerëve të këtij viti, të cilët do të udhëtojnë drejt vendeve të shenjta për kryerjen e umres dhe haxhit.

Në një intervistë për mediat lokale,

Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, tha se këto momente janë të mbushura me emocionet e një udhëtimi, sa një jetë. Ai shprehu urimet dhe lutjet e tij për haxhilerët e Shkodrës, duke theksuar se kryerja e haxhit është shprehje e besimit dhe e vullnetit për të qëndruar në besë.

Edhe Myftiu i Malësisë së Madhe, H. Edmir Smajlaj, tha se haxhi është udhëtim jete për këdo që e kryen. Ai këshilloi haxhilerët që të luten për vete, për familjet e tyre dhe për shoqërinë shqiptare.

Ndërkohë, para nisjes, haxhilerët këmbyen urimet dhe përshëndetjet më të përzemërta me përcjellësit e tyre, duke marrë si amanet porositë e shumta për lutje drejtuar Zotit të gjithësisë, në më të mirin e vendeve për adhurim.

Këtë vit, 40 haxhilerë nga Shkodra dhe Malësia e Madhe do të bashkohen me grupin e madh të haxhilerëve të Komunitetit Mysliman të Shqipërisë dhe me ata miliona muslimanë nga mbarë bota, për kryerjen e haxhit, në Mekë.

Me lot dhe urime zemre, familjarë të shumtë dhe besimtarë të pranishëm, uruan haxhilerët tanë në prag të nisjes drejt Xhidas, prej ku do të udhëtojnë për në Mekë, për të nisur ritualet e umres dhe haxhit.

BASHKËBISEDIM NË ATMOSFERËN E HAXHIT DHE KURBAN BAJRAMIT

Mbrëmjen e së xhumasë, më 18 shtator 2015, nëpërmjet ekranit të tv1 channel, Myftinia Shkodër shfaqti bashkëbisedimin që teologu Arben Halluni zhvilloi me Myftiun e Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, znj. Hidajete Kraja, z. Mithat Myftija dhe z. Arfin Tafa, mbi kuptimet e Haxhit, emocionet e vizitës së Qabes së Madhnueshme dhe mesazhet e Kurban Bajramit të sivjetshëm.

Gjatë këtij bashkëbisedimi të mbushur me emocione dhe dëshmi reale, të ftuarit përcollën mesazhet e tyre, në drejtim të respektimit dhe vlerësimit të Haxhit, si një ndër pesët shtyllat kryesore të Islamit, si dhe si një mundësi e madhe për besimtarët drejt arritjes së pëlqimit të Zotit në jetë.

Emocionet dhe shpjegimet e dhëna gjatë këtij bashkëbisedimi të dobishëm, nxorën në pah madhështinë e mesazheve të Haxhit, si: shtimi i vëllazërisë dhe bashkëpunimit në mesin e muslimanëve, nxitja për të reflektuar në drejtim të vendosjes së strategjive



ndërkombëtare për ndryshimin e gjendjes së botës islame dhe unitetit të ymnetit islam, tubimi i dijetarëve, prijësve, biznesmenëve etj, në rrugën e gjetjes së mundësive për realizimin e dëshmimit të muslimanëve ashtu si janë në të vërtetë, jo ashtu si po prezantohen sot, padrejtësisht.

Me shumë emocion u bë shpjegimi i vlerave të Haxhit si nxitës i bamirësisë,

solidaritetit në mesin e muslimanëve, afrimit të zemrave me Zotin dhe ndryshimeve të mëdha në qënien njerëzore.

Në fund, u dhanë edhe mesazhet e Kurban Bajramit, si dhe u bënë lutje që haxhilerët e këtij viti të kenë sa më shumë mbarësi dhe të kthehen me adhurime të pranuar dhe Haxh të kryer plotësisht.

PROGRAMI I KURBAN BAJRAMIT PËR XHAMITË E SHKODRËS

Pasditen e së hënës, më 21 shtator 2015, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed Sytari zhvilloi një takim konsultativ me imamët kryesorë të qytetit, me të cilët diskutoi Kurban Bajramin e sivjetshëm, faljen e tij, programin etj.

Gjatë këtij takimi u theksua se ky Bajram përkon edhe me përkujtimin e 25 vjetorit të rihapjes së xhamisë së parë pas 23 vitesh persekutimi ndaj muslimanëve dhe aktivitetit fetar, në Shkodër e mbarë Shqipërinë.

Për këtë, u ra dakord, që Kurban Bajrami i sivjetshëm të falet në të gjitha xhamitë e Shkodrës, edhe si dëshmi e mirënjohjes së muslimanëve shkodranë ndaj Zotit të gjithësisë, që mundësoi që në këto 25 vite të ndërtohen me dhjetra xhami në Shkodër, sipas kërkesës dhe domosdoshmërisë së xhemateve në rritje.

Program i Kurban Bajramit sipas tabelës së mëposhtme:

Xhamia "Ebu Bekër":

Dersi I nga teologu Idmir Plaku
Dersi II nga Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed Sytari.

Hytbeja e Kurban Bajramit nga teologu Idmir Plaku.

Xhamia Parrucë:

Dersi I nga Myftiu i Shkodrës Imam Muhamed Sytari

Dersi II nga teologu Naim Drijaj.

Hytbeja e Kurban Bajramit nga teologu Naim Drijaj.

Xhamia Kiras: Dersi I nga teologu Naim Drijaj. Dersi II nga teologu Durim Kasemi. Hytbeja e Kurban Bajramit nga teologu Durim Kasemi.

Xhamia e Medresesë: Dersi I nga teologu Gëzim Dungaj. Dersi II nga teologu Adil Cukali. Hytbeja e Kurban Bajramit nga teologu Adil Cukali.

Xhamia e Dy Vajzave: Hatme Kur'ani dhe ders nga teologu Lavdrim Hamja.

Hytbeja e Kurban Bajramit nga teologu Lavdrim Hamja.

Xhamia e Dudasit:

Hatme Kur'ani dhe ders nga teologu Nadi Braqi. Hytbeja e Kurban Bajramit nga teologu Nadi Braqi.

Xhamia e Perashit: Hatme Kur'ani dhe ders nga teologu Adem Pizga. Hytbeja e Kurban Bajramit nga teologu Adem Pizga.

Xhamia e Rusit:

Hatme Kur'ani dhe ders nga imami i xhamisë, H. Fejzi Zaganjori. Hytbeja e Kurban Bajramit nga imami i xhamisë, H. Fejzi Zaganjori.

Xhamia e Dërgutit: Hatme Kur'ani dhe ders nga teologu Ervil Kuçi. Hytbeja e Kurban Bajramit nga teologu Ervil Kuçi.

Xhamia e Tophanës: Hatme Kur'ani dhe ders nga imami i xhamisë, H. Hysejn Muça. Hytbeja e Kurban Bajramit nga imami i xhamisë, H. Hysejn Muça.

Xhamia e Plumbit: Hatme Kur'ani dhe ders nga imami i xhamisë, H. Mithat Myftija. Hytbeja e Kurban Bajramit nga imami i xhamisë, H. Mithat Myftija.

Xhamia e Ajasmës: Hatme Kur'ani dhe ders nga teologu Alban Kali. Hytbeja e Kurban Bajramit nga teologu Alban Kali. Kurban Bajrami është ditën e enjte, më 24 shtator 2015.

Namazi i sabahut falet në orën: 06.00.

BASHKËBISEDIM ME MYFTIUN E SHKODRËS, NË “STUDIO E HAPUR”



Ditën e mërkurë, më 23 shtator 2015, në prag të Kurban Bajramit të sivjetshëm, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari ishte i ftuar i gazetarit Ergys Kavaja në emisionin “Studio e hapur”, ku iu përgjigj pyetjeve të ndryshme që lidhen me kuptimet dhe mesazhet e festës së Kurban Bajramit, përgatitjes së Myftinisë Shkodër për pritjen e 16 nëntorit, si datë që shënon 25 vjetorin e rihapjes së xhamisë së parë në Shkodër e Shqipëri, pas 23 viteve persekutim ateist.

Myftiu tha se Kurban Bajrami i këtij viti do të falet në të gjitha xhamitë e Shkodrës, si shenjë falënderimi ndaj Zotit dhe si përkujtimi që duhet t'i bëjmë njëri-tjetrit për vlerën dhe mirësinë e xhamive, sidomos tani në prag të 25 vjetorit të rihapjes së xhamisë së parë pas 23 viteve persekutim.

Myftiu iu përgjigj edhe shumë pyetjeve të tjera që lidhen me pronat e Myftinisë Shkodër, vizitën e fundit të Kryetarja e re e Bashkisë Shkodër, domethënia e dhuratës së bërë, debatin që shkaktoi ajo etj.

Myftiu tha se xhamia e kalasë është një temë që nuk ka nevojë për asnjë diskutim, pasi në pesë shekujt e fundit ka funksionuar si e tillë. Ai tha se dekadave të fundit është abuzuar me emërtimin e xhamisë, por kjo, sikurse tha Myftiu i Shkodrës, duhet mbyllur një herë e përgjithmonë. “Ai objekt

është xhami dhe askush nuk ka asnjë të drejtë të pretendojë shfrytëzimin e saj, duke u nisur nga origjina e largët e xhamisë” - tha Myftiu.

Temë e këtij emisioni ishte edhe ajo e legalizimit të pronave, ku Myftiu konfirmoi se komunitetet fetare nuk ka se si të jenë të barabarta në këtë trajtim, sepse përqindjet e tyre, janë shumë të largëta, që të trajtohen të barabartë. Për këtë, ai tha se do të kishte dëshiruar që qeveritë e këtyre 25 viteve, të kishin kryer fillimisht me pronat e krejt komuniteteve të vogla, pastaj të ishte marrë me ato të muslimanëve, që jomuslimanët në këtë vend, të mos kenë vështirësi dhe të mos ndjehen inferiorë dhe të kompleksuar.

Myftiu iu përgjigj edhe pyetjes që lidhet me dhunën, vrasjet, terrorizmin dhe ekstremizmin e shfaqur kohëve të fundit në vendet islame, si dhe atakimin pa të drejtë të Islamit në këtë drejtim, ku konfirmoi qëndrimin e Islamit ndaj këtyre fenomeneve negative dhe vrastare.

Në fund, Myftiu uroi besimtarët për Kurban Bajramin, sikurse u lut që njerëzit të shpëtojnë nga klima e frikës, dhunimit psikologjik, mjerimit, varfërisë e skamjes, që ka kapluar vendin.

Emisioni do të ritransmetohet sonte, të mërkurën, më 23 shtator 2015, në orën: 20.35, në tv starplus.



*"NE BESOJMË
SE ISLAMI ËSHTË
I INTERESUAR
PËR EDUKIMIN
DHE UDHËZIMIN,
SI INTERESIMI
I TIJ PËR LIGJET
DHE EGJISLACIONIN,
MADJE PARA
LIGJEVE DHE
LEGJISLACIONIT!
SEPSE LIGJET
DHE LEGJISLACIONI
NUK PRODHOJNË
SHOQËRI,
ATO I PRODHON
EDUKIMI
DHE UDHËZIMI!"*

Shejkh Jusuf El-Karadavi

*President i Unionit Botëror të
Dijetarëve të Muslimanëve*

KURBAN BAJRAMI, DITË VËLLAZËRIMI DHE HARMONIE ISLAME

Që në orët e para të sabahut të ditës së enjte, më 24 shtator 2015, në të gjitha xhamitë e Myftinisë Shkodër kanë nisur ceremonitë e faljes së Kurban Bajramit, si një ditë e shënuar e kalendarit islam.

Sipas programit të paralajmëruar nga Myftinia Shkodër, në xhaminë e Parrucës, ceremonia ka nisur me faljen e namazit të sabahut me xhemat nën drejtimin e imamit të kësaj xhamie, teologut Naim Drijaj.

Pas namazit, në dersin e parë të kësaj dite, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari ka folur mbi rëndësinë që ka forcimi i vëllazërisë në mesin e muslimanëve. Duke iu

*Myftiu: Muslimanët,
janë njerëz që janë ftuar
ta ndërtojnë jetën,
shoqërinë, të nderojnë
dhe respektojnë këdo,
pavarësisht dallimeve
fetare, kombëtare,
kulturore etj.*

referuar ajeteve dhe haditheve të shumta, Myftiu ka thënë se sot, më shumë se asnjëherë, muslimanët e kanë për detyrë të interesohen për njëri-tjetrin dhe të punojnë për forcimin e vëllazërisë në mes vete dhe forcimit të harmonisë në mes tyre.

Në dersin e kësaj dite, Myftiu theksoi se uniteti i muslimanëve dhe respektimi i të drejtave të tyre, është një shtyllë e rëndësishme dhe e fortë e vetë harmonisë kombëtare.

Ceremonia e kësaj dite në xhaminë e Parrucës, vijoi me dersin e teologut Naim Drijaj, që mbajti njëkohësisht edhe hytben e Kurban Bajramit.

Ndërkohë, Myftiu mori pjesë edhe në ceremoninë e xhamisë "Ebu Bekër", në Fushë-Çelë, ku dha mesazhet e tij për të pranishmit e shumtë, që kishin tejmbushur xhaminë dhe oborrin e saj.

Pas dersit të mbajtur nga teologu

Arben Halluni, Myftiu u përqendrua te bashkëpunimi i muslimanëve në rrugën e dëshmimit të vlerave të besimit dhe fesë së tyre në realitetet e përditshme.

Myftiu tha se harmonia në mesin e muslimanëve, është një çështje parësore, që lidhet me vetë krenarinë dhe cilësinë e prezantimit të tyre në komunitet. Njëkohësisht tha se muslimanët, janë njerëz që janë ftuar ta ndërtojnë jetën, shoqërinë, të nderojnë dhe respektojnë këdo, pavarësisht dallimeve fetare, kombëtare, kulturore etj.


Në këtë kontekst, Imam Muhamed Sytari vuri theksin te ajo që ndodh prej kohësh në Siri dhe Irak, ku tha se terrorizmi dhe ekstremizmi fetar në emër të Islamit, është një prodhim joislam, që nuk ka dhe nuk mund të ketë lidhje me Islamin burimor dhe thelbin e mësimave të tij.

Në këtë mesazh, Myftiu përmendi edhe faktin e mirësisë së pranisë së xhamive në shoqëri, ku tha se pas pak javësh do të përkujtohet 20 vjetori i inaugurimit të xhamisë "Ebu Bekër", si dhe 25 vjetori i rihapjes së xhamisë së Plumbit.

Pas faljes së namazit të Kurban Bajramit, nën drejtimin e Myftiut, hytbeja e Kurban Bajramit u mbajt nga imami i xhamisë "Ebu Bekër", teologu Idmir Plaku. Në fjalën e tij, imami i nderuar dha mesazhe të rëndësishme që lidhen me harmoninë dhe paqen në mesin e njerëzve.

Imami Idmir Plaku theksoi se mesazhet e Kurban Bajramit janë nxitëse për të reflektuar besimin dhe përkushtimin në jetë, për t'u dëshmuar muslimanë të dobishëm dhe njerëz me vlera fetare e shoqërore.

Ceremonitë e Kurban Bajramit, u zhvilluan rregullisht edhe në të gjitha xhamitë e tjera të Shkodrës, duke dëshmuar mirësitë dhe begatitë e kësaj dite feste dhe adhurimi.



I Dërguari i Allahut (a.s)
ka thënë:

"MË E MIRA

E FESË TUAJ ËSHTË

MË E LEHTA E SAJ,

MË E MIRA

E FESË TUAJ ËSHTË

MË E LEHTA E SAJ,

MË E MIRA

E FESË TUAJ ËSHTË

MË E LEHTA E SAJ"

*(Transmeton Imam Ahmed i
me varg trasnmetimi të saktë)*



المشخة الإسلامية الألبانية
مدار الإفتاء - مدينة شكوذرا
KOMUNITETI MYSLIMAN I SHQIPËRISË
MYFTINIA SHKODËR



*"Armiku më i ashpër i Islamit
është muslimani i paditur,
që me fanatizëm
e mbron injorancën e tij
teksta e deformon
pamjen e vërtetë
të Islamit,
me veprat e tij,
duke i bërë njerëzit
të mendojnë
se ky është Islami!"*

Shejkh Ahmed Didat



Botues:
Myftinia Shkodër
Drejtues:
Imam Muhamed Sytari

Kryeredaktor:
Lavdrim Hamja

Tel / Fax:
+355 (0) 224 2081
Nr. llogarie:
100054 UBA - Shkodër

 
MYFTINIA SHKODER1990
udhaislame@myftinia-shkoder.org
www.myftinia-shkoder.org